



Datë: 06.09.2025
Numër protokolli: 3046/2025

A.nr.396/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.396/2025 të datës 28.02.2025 të parashtruar nga ankuesi S.V., D.I., D. F., A.P. i U.M., të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Eset Berisha nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komunes së Leposaviqit, në çështjen juridike “*Transferim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.396/2025 e datës 28.02.2025 e parashtruar nga ankuesi S.V., D.I., D. F., A.P. i U.M., lidhur me transferin e ankuesve nga Ministria e Ekonomisë në Komunën e Leposaviqit, sipas Marrëveshjeve të datës 07.03.2024 Nr.713, si dhe për kompensimin e ankuesëve.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, S.V., D.I., D. F., A.P. i U.M., (*tutje referuar vetëm* ankuesit), më datë 28.02.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 1353/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të transferit të jashtëligjshme dhe mos pagesës së pagave të zyrtarëve publik sipas marrëveshjeve për transfer të përhershëm në mes komunës së Leposaviqit dhe Ministrisë së Ekonomisë me pretendimin se nuk kanë pranuar pagën mujore tani e gjashtë 6 muaj dhe se transferi ka prekur edhe gradat e tyre funksionale pasi nga pozita zyrtar administrativ janë transferuar në pozitën Asistent Administrativ dhe rrjedhimisht kanë pësuar ulje page e në rastin e z.M. është ulur grada funksionale nga 7 në 6 që ka rezultuar rreth 30% ulje e pagës, prandaj konsiderohet se ulja e pagës gjatë transferimit të përhershëm është bërë në kundërshtim me ligjin në fuqi, kërkojnë ti aprovohet ankesa dhe të anulohen transferimet e zyrtarëve publik dhe të detyrohet organi i punësimit ti paguaj të gjitha pagat e mbetura duke përfshi edhe diferencën në pagë për z.M. i cili ka pësuar ulje për shkak të transferimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa Këshilli më datë 14.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 11.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesve edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokolli 1353/2025 të datës 28.02.2025 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Urgjencë për pagesë të pagave të papaguara të zyrtarëve publik për ankuesit nga avokati E.B. pa datë; Autorizim nga D.I. për E.B.; Autorizim nga S.V. për E.B.; Autorizim nga A.P. për E.B.; Autorizim nga D.F. për E.B.; Autorizim nga U.M. për E.B.; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Komunës së Leposaviqit për S.V. me nr. protokolli 713 i datës 07.03.2024; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit i Ministrisë së Ekonomisë për S.V. me nr. protokolli 2492 i datës 06.03.2024; Kërkesë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil me nr. protokolli 2411 i datës 05.03.2024; Deklarata e pëlqimit e S.V. me nr. protokolli 2485 i datës 06.03.2024; Akt Emërim i S.V. i datës 01.01.2016; Përshkrimi i detyrave të punës; Deklarata e pëlqimit e D.I. me nr. protokolli 2489 i datës 06.03.2024; Akt Emërim i D.I. i datës 01.08.2016; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit i Ministrisë së Ekonomisë për D.I. me nr. protokolli 2496 i datës 06.03.2024; Kërkesë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil me nr. protokolli 2413 i datës 05.03.2024; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Komunës së Leposaviqit për D.I. me nr. protokolli 713 i datës 07.03.2024; Akt Emërim i D.F. i datës 01.01.2016; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 11.01.2016; Deklarata e pëlqimit e D.F. me nr. protokolli 2484 i datës 06.03.2024; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Komunës së Leposaviqit për D.F. me nr. protokolli 713 i datës 07.03.2024; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit i Ministrisë së Ekonomisë për D.F. me nr. protokolli 2491 i datës 06.03.2024; Kërkesë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil me nr. protokolli 2414 i datës 05.03.2024; Akt Emërim i A.P. i datës 01.01.2016; Deklarata e pëlqimit e A.P. me nr. protokolli 2486 i datës 06.03.2024; Kërkesë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil me nr. protokolli 2416 i datës 05.03.2024; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Komunës së Leposaviqit për A.P. me nr. protokolli 713 i datës 07.03.2024; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit i Ministrisë së Ekonomisë për A.P. me nr. protokolli 2493 i datës 06.03.2024; Akt Emërim i U.M. i datës 01.01.2016; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 11.01.2016; Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Komunës së Leposaviqit për U.M. me nr. protokolli 713 i datës 07.03.2024; Vendim për transferimin e përhershëm për interes të institucionit i Ministrisë së Ekonomisë për U.M. me nr. protokolli 2490 i datës 06.03.2024; Kërkesë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil me nr. protokolli 2412 i datës 05.03.2024; Deklarata e pëlqimit e U.M. me nr. protokolli 2483 i datës 06.03.2024; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 13.03.2025; Përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë i datës 14.03.2025; E-mail nga Arkiva Me për S.V. i datës 06.03.2024; Lista e pagave në Ministrinë e Ekonomisë për ankuesit për muajin Janar Shkurt deri me 06.03.2024; E-mail nga Arkiva Me për D.I. i datës 06.03.2024; E-mail nga Arkiva Me për D.F. i datës 06.03.2024; E-mail nga Arkiva Me për A.P. i datës 06.03.2024; E-mail nga Arkiva Me për U.M. i datës 06.03.2024; E-mail nga C.Z. për L.H. i datës 10.04.2025; E-mail nga F.B. për Sh.L. etj. i datës

17.03.2025; E-mail nga F.B. për C.Z. i datës 10.04.2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokollit 2403/2025 i datës 11.04.2025.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa, ***është e pasafatshme, sepse:***

Kolegji i Këshillit, sipas pretendimeve të palëve ka konstatuar se ankuesit nuk janë paguar për periudhën 6 muajore para datës së paraqitjes së ankesës në KPMSHCK, Komuna e Leposaviqit me gjithë angazhimin e KPMSHCK-së nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka ofruar asnjë lloj dëshmi lidhur me pretendimet e ankuesve, prandaj Kolegji i Këshillit duke u bazuar në pretendimet e palëve si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë gjegjësisht nenin 25 paragrafi 1 dhe 2 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike 1. ***Këshilli bashkëpunon me institucionet e administratës publike për të kryer funksionet e tij në përputhje me këtë ligj. 2. Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin,*** dhe meqenëse ka qenë e pa mundur të konstatohen pretendimet e palëve dhe nisur nga fakti se vete palët pretendojnë se nuk janë paguar për periudhën 6 muajore, Kolegji konstaton se ankuesit i kanë humbur afatet ligjore për parashtrim të ankesës.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi S.V. sipas vendimit për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2492 të datës 06.03.2024 është transferuar nga pozita Zyrtar Administrativ në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën Asistent Administrativ në Komunën e Leposaviqit. Ndërsa i njëjti përmes e-mailit zyrtar të datës 06.03.2024 ka pranuar vendimin për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2492 të datës 06.03.2024. Ankuesi D.I. sipas vendimit për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2496 të datës 06.03.2024 është transferuar nga pozita Zyrtar Administrativ në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën Asistent Administrativ në Komunën e Leposaviqit. Ndërsa i njëjti përmes e-mailit zyrtar të datës 06.03.2024 ka pranuar vendimin për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2496 të datës 06.03.2024. Ankuesi D.F. sipas vendimit për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2491 të datës 06.03.2024 është transferuar nga pozita Zyrtar për Monitorim në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën Zyrtar i Mbikëqyrjes në Komunën e Leposaviqit. Ndërsa i njëjti përmes e-mailit zyrtar të datës 06.03.2024 ka pranuar vendimin për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2491 të datës 06.03.2024. Ankuesi A. P. sipas vendimit për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2493 të datës 06.03.2024 është transferuar nga pozita Zyrtar Administrativ në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën Asistent Administrativ në Komunën e Leposaviqit. Ndërsa i njëjti përmes e-mailit zyrtar të datës 06.03.2024 ka pranuar vendimin për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2493 të datës 06.03.2024. Si dhe ankuesi U.M. sipas vendimit për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2490 të datës 06.03.2024 është transferuar nga pozita Zyrtar Administrativ në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë në pozitën Asistent Administrativ në

Komunën e Leposaviqit. Ndërsa i njëjti përmes e-mailit zyrtar të datës 06.03.2024 ka pranuar vendimin për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë me numër protokollit 2490 të datës 06.03.2024.

Ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të transferit të jashtëligjshme dhe mos pagesës së pagave të zyrtarëve publik sipas marrëveshjeve për transfer të përhershëm në mes komunës së Leposaviqit dhe Ministrisë së Ekonomisë me pretendimin se nuk kanë pranuar pagën mujore tani e gjashtë 6 muaj dhe se transferi ka prekur edhe gradat e tyre funksionale pasi nga pozita zyrtar administrativ janë transferuar në pozitën Asistent Administrativ dhe rrjedhimisht kanë pësuar ulje page e në rastin e z.M. është ulur grada funksionale nga 7 në 6 që ka rezultuar rreth 30% ulje e pagës, prandaj konsiderohet se ulja e pagës gjatë transferimit të përhershëm është bërë në kundërshtim me ligjin në fuqi, kërkojnë ti aprovohet ankesa dhe të anulohen transferimet e zyrtarëve publik dhe të detyrohet organi i punësimit ti paguaj të gjitha pagat e mbetura duke përfshi edhe diferencën në pagë për z.M. i cili ka pësuar ulje për shkak të transferimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës së ankuesve ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1 dhe nenit 127 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...*, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesit me datë 28.02.2025 është e pasafatshme, sepse bazuar në shkresat e lëndës konkretisht përgjigjes në ankesë të datës 14.03.2025 të Ministrisë së Ekonomisë, të njëjtit vendimet për transferimin e përhershëm për interes të institucionit të Ministrisë së Ekonomisë i kanë pranuar përmes e-mailit zyrtar më 06.03.2024, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e kanë parashtruar më datë 28.02.2025 pra jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e Nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë ankesa e ankuesve është e pa pranueshme dhe si rrjedhojë e pasafatshme.

Kështu që për sa më sipër dhe duke u bazuar nën 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të pas afatshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.396/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, avokatit Eset Berisha;
- Ministrisë së Ekonomisë, Komunës së Leposaviqit
(Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.